



Human Rights Review Panel

Buletini informative # 9 – maj-qershor 2014

- Seanca e 21^{të} e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Vendimi pasues në lëndët e *Vidovdanit*
- Përditësim në vendime dhe komunikime
- Prezantim për studentët e programit master për të drejtat e njeriut të Universitetit të Essex-it
- Statistikat e lëndëve

Seanca e 21^{të} e PShDNj-së

Seanca e 21^{të} e rregullt e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) është mbajtur në Prishtinë nga 26-28 maj 2014. Paneli ka shqyrtuar 19 ankesa dhe ka marrë vendime në dhjetë lëndë. Paneli ka lëshuar një vendim pasues në lidhje me dy lëndë lidhur me festimet e *Vidovdanit* të vitit 2012. Tetë lëndë janë shpallur të papranueshme. Më tej, Paneli ka vendosur t'i komunikoj tetë lëndë tek shefi i Misionit të EULEX-it, duke e ftuar atë për të komentuar mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e këtyre ankesave.

Vendimi pasues në dy lëndë të *Vidovdanit*

Në një vendim pasues në lidhje me lëndët [*H&G kundër EULEX-it*](#) (vendimet 2012-19&20) Paneli ka konstatuar se shefi i Misionit të EULEX-it ka ushtruar funksionet e tij me zell dhe në mënyrë efektive në zbatimin e shumicës së rekomandimeve të Panelit. Këto lëndë kishin të bëjnë me dy ankues, të cilët kanë pohuar se iu ishin nënshtruar sulmeve nga Policia e Kosovës më 28 qershor 2012, gjatë festimeve të *Vidovdanit*.

Paneli ka përsëritur gjetjet e veta në lidhje me masat operative të ndërmarra nga EULEX-i sa i përket lëndëve [*A,B,C&D kundër EULEX-it*](#) (vendimet 2012-09 deri më 14) dhe i ka konsideruar se ato përbëjnë zbatimin e duhur të rekomandimeve të Paneli. Këto veprime përfshinin, *ndër të tjera*, zhvillimin paraprak të vlerësimit të rrezikut, zhvillimin e planeve të hollësishme operative, bashkërendimin e ngushtë ndërmjet të gjitha palëve të interesuara në operacionin e sigurisë, si dhe nxjerrjen e udhëzimeve të qarta për Policinë e EULEX-it rreth çështjeve të të drejtave të njeriut që mund të ngritën gjatë këtyre ngjarjeve.

Si në vendimet e mëparshme, Paneli ka vënë në dukje se shefi i Misionit nuk kishte pranuar zyrtarisht shkeljen e të drejtave të njeriut të ankuesve përkundër rekomandimit të Panelit për atë qëllim. Paneli ka vënë në dukje edhe një herë se pranimi i shkeljeve nga shtetet është një praktikë e

vendosur mirë në procedurat, ndër të tjera, pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe po ashtu zbatohet rregullisht nga Paneli Këshillëdhënës i të Drejtave të Njeriut i UNMIK-ut. Paneli ka ftuar shefin e Misionit për t'i shfrytëzuar mjetet ligjore në dispozicion të tij, pasi pranimi formal i shkeljes së të drejtave ka mundësi që të ofroj një korrigjim për viktimën e shkeljes së të drejtave të njeriut. Duke marrë parasysh kufizimet e vendosura në aftësinë e Panelit për të rekomanduar kompensim financiar, siç është përcaktuar me Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, pranimi formal i një shkeljeje nga ana e autoritetit kompetente bëhet edhe më e rëndësishme si një formë e korrigjimit të shkeljes së të drejtave individuale.

Vendimi i pranushmërisë

Paneli ka shpallur një lëndë të pranueshëm ([Becec kundër EULEX/2013-03](#)). Ankesa ka të bëjë me uzurpimin e dyshuar të një banese në Prishtinë nga palët private. Ankuesi pohon se autoritetet e Kosovës duke përfshirë edhe policinë e Kosovës dhe prokurorin e Kosovës nuk kanë ndërmarrë masat e duhura, se rasti ka përbërë në diskriminim ndaj tij nga këto autoritete dhe se refuzimi i tyre për të vazhduar me padinë e tij e kishte ndaluar atë nga qasja në mjetet efektive juridike. Më tej, është pohuar se EULEX-i nuk kishte arritur të reagoj në mënyrë të duhur ndaj ankesës së tij dhe kështu kishte shkelur të drejtën e tij të njeriut në mjetet efektive dhe të drejtën e tij në gëzimin e qetë të pronës së tij.

Vendimet e papranueshmërisë

Një nga lëndët e shpallur e papranueshme ([V kundër EULEX/2013-23](#)) kishte të bënte me procedurat pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Paneli ka përsëritur se në parim nuk kishte juridiksion as rreth aspekteve administrative e as gjyqësore të punës së gjykatave të Kosovës. Prandaj ankesa ka dalë jashtë kuadrit të kompetencave të Panelit. I njëjti arsyetim është përdorur në dy vendime të tjera të papranueshmërisë ([Taraku kundër EULEX-it/2013-26](#) dhe [Kadriu kundër EULEX/2013-27](#)) lidhur me kontestet për punësim, në një lëndë tjetër që kanë të bëjnë me të drejtat për pension ([Krasniqi kundër EULEX/2014-04](#)) dhe në një lëndë në lidhje me mos zbatimin e të drejtave për alimentacion ([Rastelica kundër EULEX-it/2014-07](#)).

Një lëndë tjetër ([A.Z. kundër EULEX-it/2014-03](#)) kishte të bënte me një varg krimesh të dyshuara që ankuesi i kishte raportuar tek autoritetet vendore, të cilët pas kryerjes së një hetimi paraprak të çështjes, kishin vendosur për të mos bërë hetime të mëtejme. Pasi që EULEX-i nuk ishte përfshirë në asnjë cilësi në këtë çështje, ankesa ishte shpallur e pabazuar.

Në një lëndë tjetër ([B.Y kundër EULEX/2014-06](#)), ankuesi ka pohuar se i ishte nënshtruar sulmeve të vazhdueshme nga fqinjët e tij. Prokurorët e EULEX-it kishte shqyrtuar ankesat në dy raste dhe pas kësaj kishin vendosur që mos të ngritin procedura penale. Paneli ka vënë në dukje se në bazë të informacionit të paraqitur nuk mund të konkludohet se vepra penale e dyshuar do të bie në kuadër të autoritetit të prokurorëve të EULEX-it.

Komunikimi i ankesave

Paneli ka vendosur që të komunikoj shefit të Misionit të EULEX-it shtatë lëndë që lidhen me fatin e shtatë individëve, të cilët dyshohet se ishin vrarë në vitin 1999. Ankuesit pohojnë se EULEX-i ka dështuar të kryej hetimet lidhur me vdekjet e dyshuara të të afërmeve të tyre. Paneli ka kërkuar nga shefi i Misionit që të ofroj vërejtjet e tij mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e këtyre lëndëve. Komunikimi tjetër tek shefi i Misionit ka të bëjë me taksat gjyqësore dhe koston e përkthimit të

dokumente në procedurën para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Prezantimi i PShDNj-së për studentët e Universitetit të Essex-it

Më 16 qershor 2014, EULEX-i ka organizuar një varg prezantimesh një grupi të studentëve të programit master për të drejtat e njeriut nga Universiteti i Essex-it. Panelit iu është dhënë mundësia të prezantoj mandatin, procedurat dhe punën e vet.

Diskutimi që pasoi është përqendruar në lëndët e Panelit, pavarësinë e tij, vendimet lidhur me shkeljeve të drejtave të njeriut dhe rekomandimet e Panelit bërë EULEX-it për t'ju qasur këtyre shkeljeve, si dhe aktivitetet e fushatës informuese të Panelit.




Zyrtari ligjor: Florian Razesberger duke bërë prezantimin para studentëve të programit master në zyrat kryesore të EULEX-it.

Fushata informuese

Ndër aktivitetet e tjera gjatë fushatës informuese, Sekretariati i Panelit është takuar me bashkërenduesin e zyrës për Kosovë dhe Metohi në pjesën veriore të Mitrovicës më 26 qershor 2014 për të informuar mbi aktivitetet e Panelit dhe ndër të tjera, për ta çuar përpara fushatën informuese në rajonin e Mitrovicës veriore.

Statistikat e lëndëve - korrik 2014



PARASHTRIMI I ANKESAVE

(Rregullat 25 dhe 26 të rregullores së punës të PShDNj-së)

Kush?

Çdo person i cili nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të dyshuara, të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Paneli nuk do t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

Kur?

Ankesa duhet t'i parashtrohet Panelit brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

Si?

Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe. Normalisht, ankesa duhet të plotësohet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular.

Nëse ankesa paraqitet me anë të letrës, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tej.

Ku?

Ankesa mund të parashtrohet në

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - sekretariati

Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 28 2125

Ankesa gjithashtu mund të parashtrohet përmes postës elektronike në: office@hrrp.eu

www.hrrp.eu

Plotësimi i formularit për ankesë

Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter.

Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë kontaktuese të ankuesit.

Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale.**

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm dhe me një përshkrim të shkurtë (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.).

Ankesës i caktohet numri i dosjes. Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai/ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij/saj të bëhet publik, ai/ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.